

VENDIM
Nr. 244, datë 20.4.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 920, DATË 25.11.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME PAGË E SHITESA MBI PAGË DHE PËR PROCEDURËN E KOMPENSIMIT FINANCIAR GJATË QËNDRIMIT NË PUNË TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1, e vendimit nr. 920, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë dhe për procedurën e kompensimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësve të Policisë së Burgjeve”, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2023, përballohen nga fondet e kontingjencës, të miratuara për vitin 2023.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Policia e Burgjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrihet efektet financiare nga data 1 prill 2023.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 1

Paga bazë mujore për gradë për punonjësit e Policisë së Burgjeve

Roli	Grada	Paga bazë për gradë
1	2	3
Bazë	Aspirant	59 000
	Nëninspektor	61 500
	Inspektor	64 000
	Kryeinspektor	68 500
I mesëm	Nënkomisar	75 000
	Komisar	82 500
	Kryekomisar	106 000
I lartë	Drejtues	123 000
	Drejtues i lartë	133 700